



Npi – 01/172 datë: 02.05.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 7, 8, 10 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04/L-071; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi listën e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve Npi – 01/45 datë: 12.02.2025, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komisionit Npi-01/60 të datës 13.03.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, Kuvendi i Komunës në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 02.05.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË BASRI MIKULLOVCI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më: 02.05.2025, me shumicën e votave vendosi të REFUZOJË Kërkesën Nr: 06-350/2-19260/24 datë 30.07.2024, të Basri Mikullovcit, për ndrrimin e emrit të rrugës "17 Shkurti" me emrin "Vllezërit Mikullovcit".

II

Kërkesa: z.Basri Mikullovcit, Rr. "Qazim Mikullovcit" Nr.12 Godanc i Poshtëm, Kërkesa Nr: 06-350/2-19260/24 datë 30.07.2024, ka kërkuar ndrrimin e emrit të rrugës "17 Shkurti" në Godanc të Poshtëm, dhe të zëvendësohet me emrin e ri "Vllezërit Mikullovcit". Kërkesa është Individuale, me një listë (kopje) të 140 emrave të banorëve të kësaj rruge siç ka thënë pala, me nënshkrime të pa verifikuara në 4 fletë A4. Lista nuk ka numra të Letërnjoftimeve, dhe nuk ka Titull se për fare arsye janë kërkuar nënshkrimet. Arsyeimi është dhënë si vijon: Pas ngritjes së Flamurit në Vlorë më 1912, gjatë rrugës duke u kthyer për në shtëpi, tre (3) Vllezërit Mikullovcit me emrat: 1. Asllan Mikullovcit, 2.Xhemajl Mikullovcit, dhe 3.Ismajl Mikullovcit, hasën në pritë të okupatorit serb të cilët i malltretuan në mënyrën më mizore dhe në fund i likuiduan në Qafë të Duhles, ku edhe sot ndodhet lapidari. Ne kemi bërë kërkesë Nr.06-350-794 datë: 06.04.2013 edhe atëherë kur është bërë emërtimi i rrugëve, por nuk është marrë parasysh, prandaj kërkojmë që kjo kërkesë të rishqyrtohet edhe një herë, dhe të miratohet.

III

A r s y e t i m:

- Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes në mbledhjen e -III- të mbajtur më 06.12.2024, unanimisht miratoi Konkluzionin Npi-01/397 datë 06.12.2024 me të cilin vendosi që kërkesën Nr:06-350/2-0019260/24 datë 30.07.2024, të z.Basri Mikullovcit nga fshati Godanc i Poshtëm, ta shqyrtoi pak më detaisht, duke kërkuar nga pala informacione shtesë lidhur me atë se nëse pala është i pajtimit, që të ndryshohet emri i rrugës "Qazim Mikullovcit" me emrin "Vllezërit Mikullovcit". Ndërsa sa i përket ndrrimit të emrit të rrugës "17 Shkurti" siç është

kërkuar nga pala, me emrin “Vllezërit Mikullovcit” për Komisionin nuk është e pranueshme sepse 17 Shkurti është dita e Pavarësis së Kosovës.

- Komisioni për shqyrtimin e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes me rekomandimin Npi-01/60, pas diskutimit me palën dhe grumbullimit të informatave, në mbledhjen e mbajtur më 06.12.2024, unanimisht, i Rekomandon Kuvendit Refuzimin e Kërkesës Nr: 06-350/2-19260/24 datë 30.07.2024, të Basri Mikullovcit, për ndrrimin e emrit të rrugës “17 Shkurti” me emrin “Vllezërit Mikullovcit”.
- Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2025 miratoi Rekomandimin, Npi – 01/118, me të cilin Kuvendit të Komunës i Rekomandon Refuzimin e kësaj kërkesë.
- Duke marrë parasysh të gjitha këto Kuvendi mori vendim sikurse në Dispozitiv.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi